



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimeno / Prilimeno Received / Delivered	03.06	2022	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. Unit	SKDMSHCK	3251/2022	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.412/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.412/2022 të datës 22.04.2022 të parashtruar nga ankuesit: _____ dhe _____ e regjistruar në emër të ankuesit _____ të përfaqësuar me autorizim nga Avokat _____ me adresë:

_____ kundër organit të punësimit/Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **JO KOMPETENT** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.412/2022 të datës 22.04.2022 të parashtruar nga ankuesit:

A r s y e t i m

Ankuesit, sipas shkresave të lëndës të punësuar në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, me datë 18.03.2022 kanë parashtruar kërkesë tek Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Mitrovicës dhe po ashtu me datë 18.03.2022 kanë parashtruar kërkesë në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave.

Kundër përgjigjes së datës 21.04.2022 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, ankuesit me datë 22.04.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli:2323/2022 me pretendimet ankimore për ngritje të koeficientit dhe kompensimit në



mënyrë retroaktive nga viti 2013 si dhe kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesit dhe

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Ndërsa Këshilli me datë 12.05.2022 ka pranua nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:2740/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.prot:2323/2022 të datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e përfaqësuesit të ankuesit Autorizimin e përfaqësuesit të ankuesit Autorizimin e përfaqësuesit të ankuesit Kërkesën e ankuesve të datës 18.03.2022 drejtuar Komunës së Mitrovicës, Kërkesën e ankuesve të datës 18.03.2022 drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, Dëftesën e fletë dërgesës përmes poste e datës 18.03.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 21.04.2022 të Menaxherit të Personelit në AME; E-mailin e datës 22.04.2022 dërguar nga përfaqësuesi i ankuesve në Këshill; Kërkesën e datës 20.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.04.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.05.2022; Listën e deklarimit të statusit zyrtar për të punësuarit në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave; Përgjigjen në kërkesë e datës 21.04.2022; Akt emërimit e datës 31.07.2013 të ankuesit Akt emërimit e datës 31.07.2013 të ankuesit Akt emërimit e datës 31.07.2013 të ankuesit Akt emërimit e datës 31.07.2013 të ankuesit

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi.

sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresa të lëndës, respektivisht akt emërimeve të ankuesve, ka konstatuar se ankuesit dhe janë të punësuar në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave në pozitën "Zjarrfikës", ndërsa sipas deklarimit të statusit zyrtar nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë DMZP/MPB të përcjellë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, pozitat e punës "Zjarrfikës" janë përcaktuar në kategorinë "**Nëpunës i Shërbimit Publik**".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. **Nëpunës Civil**- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike", dhe si



rrijedhojë ka konstatuar se Zjarrfikësit e kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.412/2022 të datës 22.04.2022 të parashtruar nga ankuesit si në dispozitiv të vendimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.412/2022

Flakron GASHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

